

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Macron vizitë zyrtare në Spanjë, takime me Mbretin Felipe dhe Sanchez për Ukrainën dhe Lindjen e Mesme - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/macron-vizite-zyrtare-ne-spanje-takime-me-mbretin-felipe-dhe-sanchez-per-ukrainen-dhe-lindjen-e-mesme/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 10:31:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 10:30:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ce678818df09fba92d7f2554ca1faa47bbb38b416b966c408eac633460f313364
TEKSTI	ff35e74a1e5a8afc6f105823ac59e8e3c0ad05da962ad1b0791688b72c489699
PAMJA	dcdac871fa45d13b461998df72200d47f9ae7b7b06dc320937cecaa626d1fc70

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ce386e7c02f0d72ead28c488dcda2742c84ed7c4bfa207318c60984fbddf1e41
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	fa5011856be057622e11e3b7b9503371417a521d23e6e858a13f19aee6db6a1d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ce386e7c02f0d72ead28c488dcda2742c84ed7c4bfa207318c60984fbddf1e41>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Viti i ri shkollor Lufta në Iran Donald Trump Protesta në Tiranë

BOTA

Macron vizitë zyrtare në Spanjë, takime me Mbretin Felipe dhe Sanchez për Ukrainën dhe Lindjen e Mesme

14 Shtator 2026 | 12:30

Presidenti francez Emmanuel Macron dhe bashkëshortja e tij do të bëjnë një vizitë zyrtare në Spanjë më 29 dhe 30 shtator, njoftoi këtë të hënë presidenca franceze dhe qeveria spanjolle.

Vizita do të zhvillohet me ftesë të Mbretit Felipe dhe çifti presidencial francez do të takohet me kryeministrin spanjoll Pedro Sanchez për të biseduar mbi çështje që përfshijnë situatën në Lindjen e Mesme dhe Ukrainën.

“Kjo vizitë e parë zyrtare e një presidenti francez në Spanjë që nga viti 2009 do të tregojë thellësinë e lidhjeve që lidhin dy vendet tona, si dhe gjerësinë e bashkëpunimit të tyre”, tha presidenca franceze në një deklaratë.

Si pjesë e kësaj vizite, një darkë zyrtare do të shtrohet për nder të tij nga Mbreti Felipe VI dhe Mbretëresha Letizia, ndërsa Emmanuel Macron do të pritet edhe nga Kryeministri Pedro Sanchez më 30 shtator, shtoi pala spanjolle.

“Të dy vendet ndajnë një angazhim të përbashkët për të mbrojtur demokracinë dhe të rinjtë, veçanërisht përballë sfidave të paraqitura nga mediat sociale dhe inteligjenca artificiale”, tha Pallati Elysee në deklaratën e tij, duke shtuar se Sanchez dhe Macron do të diskutojnë “çështje të rëndësishme evropiane dhe ndërkombëtare, përfshirë situatën në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme”, gjatë takimit të tyre.

Vizita e fundit e Emmanuel Macron në Spanjë ishte në janar 2023. Ai më pas nënshkroi një traktat miqësie me Pedro Sanchez, i cili ende nuk është ratifikuar nga Spanja për shkak të kundërshtimit të së djathtës spanjolle ndaj disa prej dispozitave të tij.

Emmanuel Macron vizitoi gjithashtu Sevillen verën e kaluar për të marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Financimin e Zhvillimit.

Shiko në:

LAJMI I FUNDIT

12:26 Kina: Nuk i kemi dhënë Iranit imazhe satelitore para sulmit vdekjeprurës në bazën amerikane në Jordani

12:03 Aksident fatal në aksin Bradashesh-Peqin! Makina përplas të moshuarin që lëvizte me biçikletë, ndërron jetë 70-vjeçari

11:59 Fyeu liderin suprem të Iranit, mesazhi prekës i blogeres pasi mësoi se u dënua me vdekje:

Thashë atë që besojta
SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

11:57 Rikativizohet vullkani Etna, aeroporti i Katantias ndalon fluturimet

11:46 U plagosën në Iran, dalin pamjet e shpëtimit të dy oficerëve amerikanë të Forcave Ajrore (VIDEO)

11:34 Bllokuan bulevardet dhe akset kryesore gjatë protestës së djeshme në Tiranë, procedohen 20 persona

TESTIM

BOTA

Kina: Nuk i kemi dhënë Iranit imazhe satelitore para sulmit vdekjeprurës në bazën amerikane në Jordani

Pekini i ka quajtur të pabaza raportet se subjektet kineze i kanë dhënë Teheranit imazhe satelitore të një baze ushtarake në Jordani si para ashtu...

12:26 | 14/09/2026

BOTA

Fyeu liderin suprem të Iranit, mesazhi prekës i blogeres pasi mësoi se u dënua me vdekje: Thashë atë që besoja

Një blogere 33-vjeçare iraniane është dënua me vdekje nga një Gjykatë Revolucionare në Bandar Abbas, në një çështje që ka ngritur shqetësime të reja mbi...

11:59 | 14/09/2026

BOTA | EVROPA

Rikтивizohet vullkani Etna, aeroporti i Katanias ndalon fluturimet

Fluturimet në aeroportin e Katanias në Itali u pezulluan përsëri të hënën për shkak të hirit vullkanik nga aktiviteti i vazhdueshëm i malit Etna. Kështu...

11:57 | 14/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara Punësimi

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: